



REPUBLIKA E KOSOVËS ♦ REPUBLIKA KOSOVA ♦ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT ♦ OPŠTINA UROŠEVAC ♦ MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 10/2024

I Mbajtur në takimin e X-të të rregullt të KK-së me datën 31.10.2024, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi i KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e X-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KK-së;
4. Propozim – Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për Vitin 2025;
5. Propozim – Vendim për lirimin – faljen e qirave për lokalit në Rr.“Ramadan Rexhepi” në pronësi të Komunës;
6. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator për Vitin 2024;
7. Propozim – Vendim për Miratimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Plani i Veprimit për Rininë 2024-2027;
8. Propozim – Vendim për publikimin e listës së pronave të Komunës së Ferizajt për dhënie në shfrytëzim për Vitin 2025;
9. Propozim – Vendim për Këmbimin e pjesës së ngastrës kadastrale; 706-0, Z.K. Lloshkobare, pronë e Komunës së Ferizajt, me pjesën e ngastrës kadastrale 705-3 dhe 705-4 Z.K. Lloshkobare, pronë private;
10. Propozim – Vendim për Këmbimin e pjesës së ngastrës kadastrale; 992-0, Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt, me ngastrën kadastrale 376-1 dhe 378-3 Z.K. Nerodime e Ulët, pronë e Këshillit të Bashkësisë Islame Ferizaj;
11. Pyetje dhe kërkesa dhe
12. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i falenderoj për pjesëmarrje dhe e lexoi rendin e ditës së lartë cekur dhe pyeti nëse ka dikush rreth rendit të ditës dhe fjalën e mori Drejtoresha e financave e cila propozoi të shtyhet pika 4 për seancën e radhës pasi që ministria e ka pezulluar përkohësisht apo të shtyhet për vitin 2026. Kryesuesi pyeti nëse ka dikush tjetër dhe fjalën e morri Brahim Osmani i cili theksoi se edhe ne si grup parlamentar e mbështesim pasi unë edhe dje e kam njoftuar drejtoreshën që kjo u shty për vitin 2026, por ajo që më bënë të ndjehen mirë pasi kërkesat e antërëve të KPF-së ja kemi shpreh edhe ministrit dhe besoj që ai na ka dëgjuar, edhe kërkojë që edhe ju të na ndëgjoni neve kur po ju themi mos keqpërdorni.

Sebahate Ajeti theksoi se ministri e ka bërë këtë njoftim përmes një konference dhe diçka zyrtare të dokumentuar nuk kemi dhe besoj që ministri këtu ka vepruar me nguti dhe më pas u tërhjek nga ky vendim. Kryesuesi pasi theksoi se ska për diskutim rreth rendit të ditës, u hodh në votim dhe kaloi me të gjitha votat për.

Kryesuesi theksoi se para se të fillojmë me rendin e ditës kërkojmë me një minutë heshtje të nderohet Sylejman Selimi.... i përjetshëm qoftë emri i tij.

Sa i përket pikës së tretë procesverbalit a ka dikush diçka të diskutoi, fjalën e morri Arbnora Salihu e cila pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se një pjesë e konsiderueshme e fjalimit tim tek pjesaku kemi diskutu për projekt buxhetin mungon dhe kërkoj që ajo pjesë të plotësohet, ju faleminderit dhe pasi spati të tjerë edhe procesverbali kaloi me të gjitha votat për.

Kryesuesi theksoi se e kemi hjek pikën e 4 dhe vazhdoi me pikën e 5 dhe fjalën ja kaloi drejtoreshës së financave e cila pasi e lexoi propozimin ashtu si në dokument të propozim vendimit, dhe kërkoj që kjo të votohet si e tillë.

Flamur Istrefi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se ne jemi për si grup për shkak të punëve mirëpo propozoj që të gjejë forma që të subvencionoj edhe për firmat tjera pasi i njejt projekt i ka prek edhe bizneset tjera ju faleminderit.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se edhe jemi për, mirëpo selektimi po ndodhë këtu pasi vetëm një lokal po lirohet nga pagesat edhe pse këto punë kanë bërë dëme për biznese tjera, mirëpo që si keni mbështet andaj unë propozoj që ose të shtyhet ose te marrim një vendim për të gjitha.

Arian Imeri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se ne para vetes kemi një propozim për faljen e qiras, andaj kërkesa e kolegve është e një natyre tjetër dhe mendoj që nëse jemi për ta aprovuar këtë vendim, ndërsa propozimet e tjera le të shikoj komuna se si mund të ju ndihmohet ne edhe gjatë kohës së pandemisë kemi ndihmuar apo falur vetëm ato që kanë qenë të komunës.

Hatixhe Bungu pasi përshëndeti të gjithë theksoi se edhe unë pajtohem me parafolsit si tha edhe Ariani ne duhet me patjetër me aprovu këtë vendim dhe të shikohet nëse komuna ka mundësi le të bëjnë palët kërkesa dhe ky kuvend të formojë një komision, e të shikohet.

Flamur Istrefi theksoi se spe kushtëzojmë këtë pikë po e mbështesim dhe të shikohet në ditet tjera për bizneset tjera. Kryesuesi e hodhi në votim dhe kjo pikë kaloi me të gjitha votat për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 6 dhe ia kaloi fjalën Drejtoreshës së Financave Sebahate Ajeti Sadiku e cila e lexoi Raportin financiar ashtu si ishte i propozuar edhe në materialet e kuvendit të komunës për këtë seance. Dhe i njejtë pasi është vetëm raport nuk ka nevojë të votohet.

Kryesuesi e lexoi pikën e 7 që ka të bëjë me strategjinë për rininë dhe pasi drejtoresha s'është këtu kemi të bëjmë me këtë strategji e cila ka kaluar të gjitha fazat diskutimet publike etj.

Verona Isaku - Faleminderit kryesues
Përshëndetje për te gjithë.

Sot kemi para

nesh një dokument me rëndësi të madhe, i cili do të duhej të planifikonte vizionin për rininë. Me gjithatë, përmbajtja e tij aktuale nuk përkon me realitetin dhe nuk është në përputhje me dokumentet e ngjashme në nivel vendi.

Kryetari i komunes ka vargje te mira për t'i thurur për rininë dhe mundohet të tregojë angazhimin e tij për ta duke shtuar dhe zbuluar aktivitetet e tij, megjithatë, marrim shembull, realiteti në shkollën Shaban Hashani tregon tjetër histori. Gjendja e mjerueshme në këtë shkollë është dëshmi e qartë se kujde si i tij nuk reflektohet në infrastrukturen arsimore, nxënësit do të duhej të kishin një mjedis stimulues për edukim. Kjo situatë përpos që dëmton të ardhmen e tyre, ajo ushqen edhe dëshperimin e dëshirën e tyre për të ikur nga vendi, pra ju po kontribuoni duke mos i përmirësuar kushtet. Kryetari i komunes duhet ta kuptoj se fjalët e mira duhet të shoqërohen me veprime konkrete.

Pushteti i tanishëm ka një etje të madhe për ta shpërblyer organizatën Flutura Academy, ku pasi ia dha objektin në pronësi të komunës, pa asnjë procedur duke e anashkaluar totalisht kuvendin komunal, pra dhënje në shfrytëzim jashtëligjshëm, me kete plan te veprimit parasheh qe me ia siguru edhe 4,500.00euro kinse për të mirë te të rinjëve, Vetem qeverisje e mirë nuk është.

Plani i Veprimit e parasheh një buxhet prej 250,000.00 euro, mjete të cilat ky pushtet e ka te pamundur t'i siguroj, sepse për shkak të keq menaxhimit këtij pushteti vazhdimisht i bllokohen llogarit nga përmbaruesit, pra ka shumë gjasa që ky plan veprimi do ju mbetet plan në letër.

Është shqetësuese që ky plan dhe strategji nuk janë në përputhje me parimet dhe prioritetet e përcaktuara në nivel nacional. Kjo tregon se procesi i hartimit ka qenë i ngutshëm dhe pa një strategji të qartë. Një qasje e tillë, e cila duket se është e bërë "shkel e shko", nuk do të sjellë rezultate të qëndrueshme dhe do të injorjé nevojat e vërteta të rinisë.

Përfshirja e rinisë përdoruese të drogave do te duhej te kishte një fokus kryesor në planin e

veprimit. Kjo dukuri është një nga sfidat më të mëdha me të cilat po përballet rinia e Ferizajit dhe ka implikime serioze për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Një plan veprimi që adreson këtë problem duhet të përfshijë strategji për parandalimin, mbështetje për rehabilitimin dhe krijimin e mundësive për rinovim.

Nga ky pushtet, rinia shikohet si një mjet për përfitime politik edhe imazh të mirë, në vend që të konsiderohet si një grup me nevoja dhe sfida të vërteta. Një qeverisje që nuk e vlerëson rininë si prioritet, por vetëm si një mundësi për t'u dukur mirë, është e destinuar të dështojë në përpjekjet e saj për të krijuar një të ardhme më të mirë për ata, për të realizuar një ndryshim të vërtetë, është e nevojshme që të ketë një angazhim të sinqertë nga pushteti dhe një dëshirë për të investuar në rininë dhe në zgjidhjen e problemeve që ata përballen. Pa këtë angazhim, çdo plan do të mbetet thjesht një shpresë e porealizuar.

Zgjedhja ad hoc e kësaj grupe punuese, pa një proces transparent është mjaft shqetësuese. Drejtoresha ka konsideruar se nuk po përfaqësohet mjaftueshëm familja e saj vetëm me prezencën e saj, ajo ka shtuar edhe kunatin e saj në mënyrë që të tregojë përfaqësimin e familjes Shabani.

Pra drejtoreshë, e ke obligim me ju tregu votuesve tu se çka do të thotë nepotizëm për ty, duhet të ju tregosh që sa të jesh t'i nuk ka vend për të tjerët, e ke obligim të ju tregosh se ku i ke lane mjetet të cilat i ke përfituar nga KUSA dhe sa është shuma që e ke përfituar.

LDK-ja ka gjithmone ka vote pro mireqenies se rinise, por asnjëherë nuk do të jetë pro atyre që në emër të rinisë përfitojnë për vete dhe familjaret e tyre.

Nga kjo foltore u bëj thirrje të gjithë të rinjve, që Strategjinë e zhvillimit të rinisë e gjeni në Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe asnjëherë në të tillë pushtetar që rininë e shohin trampolinë për përfitime personale!

Erëza Hashani - Sot kemi para vetes një dokument me rëndësi të jashtëzakonshme për planifikimin e politikave të rinjve në nivelin lokal. Strategjia për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizat 2024-2029 si dhe Plani i Veprimit për rininë 2024-2027, paraqesin dy dokumentet baze mbi të cilat zënë fill politikat rinore në Komunën e Ferizat, duke shprehur qartë vizionin që ka Kryetari i Komunes së Ferizajt, për të rinjtë, duke fuqizuar rolin e tyre në shoqëri.

Ky dokument, përmban objektiva të qarta në adresimin e nevojave, kërkesave dhe ecjes përpara të rinjve në Komunën e Ferizajt, andaj si e tillë, duhet të mbështetet nga të gjithë ne, duke i dhënë të rinjve përmes këtij dokumenti - infrastrukturen ligjore të nevojshme, bazën mbi të cilën projektohen politikat lokale në këtë fushë.

Kryetari Agim Aliu vazhdueshëm ka dëshmuar qasjen e tij në mbështetje të të rinjëve, duke qenë edhe qeverisja lokale, shembull i vendimmarrjes të të rinjëve.

Qeveria lokale e udhehequr nga Kryetari Agim Aliu është vlerësuar qeverisja me moshën më të re në gjithë historinë politike të Ferizajt, andaj mjafton ky fakt për të vlerësuar qasjen që ka kreu i Komunes ndaj të rinjëve. Këtu shtojmë faktin edhe të mbështetjes me bursa për studentet ferizajas, ku për vite me radhë, janë mbështetur të gjithë aplikuesit për bursa, qindra studente, rjedhimisht qindra familje që kanë pasur dhe kanë mbështetjen e Komunës në këtë drejtim.

Ky dokument që përmban në vete një varg veprimesh në fushën e politikave rinore, është dokument themelor mbi këtë sektor, andaj ju ftoj ta mbështesim këtë propozim.

Ju faleminderit.

Brahim Osmani, unë se kam ndërmend me dalë, po me nxiti Erëza, për shkak që i përmendi disa gjana, strategjia është punë që kryetari çka duhet të bëjë për rini, nëse kjo udhëheqje e PDK-së është pra edhe kuvendi edhe drejtortë janë të gjithë nga PDK janë mbi 50 vjet, strategjia kjo që keni prurë është vetëm në letër por ska me pas asnjë efekt ju faleminderit.

Arian Imeri pasi përshëndeti të gjithë theksoi se na nganjëherë spe di a pe dimë çka jemi tu diskutu. Dhe zakonisht këto drafte vijnë nga niveli qendror dhe a mund kolega me na thanë që çka s'është e harmonizime me nivelin qendror dhe e shikojmë ose cili ke propozimi juaj konkret çka me ndryshu.

Arbnora Salihu, pasi përshëndeti të gjithë dhe mendoj që kolegët nga opozita prap po vazhdojnë me këtë krahurën e njëjtë të fjalimeve tyne, gjithësesi spo du me u nalë në këtë nivel, mirëpo kur flitet për rinin e PDK-së e të Agim Aliut, dhe e keni gabim nëse mendoni që ai nuk ju ka dhënë mundësi, pasi ai është për krejt rinin e qytetit dhe jo vetëm për rininë e PDK-së dhe është mirë kur dilni këtu, duhet me folë për krejt rininë dhe jo me theks të veçantë për atë të PDK-së, pasi e di që këtu ju djeg, pasi kryetari ka bërë shumë punë duke filluar nga bursat, e tu vazhdu me gjana tjera, me folë për këtë strategji edhe unë mendoj që nuk është e duhura, mirëpo propozimet janë të nevojshme në këtë drejtim, fillimisht është mirë na me e pas një strategji dhe kjo po bëhet për herë të parë, dhe pavarësisht implikimeve financiare unë mendoj që do të bëhet një zgjidhje, mendoj që kjo duhet fillimisht të kalojë, e më pas të shihen implikimet buxhetore.

Flamur Istrefi me nxiten diskutimet e kolegeve, kolegja Verona nashta i dha pak ngjyrim politike, mirëpo komentet kenë të gjitha konkrete, tregojë që kjo strategji nuk është harmoni me atë nacionale, tregoj që ka ngjyrim të nepotizmit të grupit punues, tregojë që një biznesit ja keni dhënë Qendrën e inovacionit dhe tash po i jep edhe subvencion dhe ska asgjë të planifikime për përdoruesit e drogave, koleg'ja tha që po folë për krahur dhe më pas dulë që foli krejt për politikë.

Arian Imeri pasi përshëndeti të gjithë pra nëse i shikoni aktivitetet p.sh. shtimi i psikologve dhe inistitucioni që ka me i implementu është ministria arsimit dhe drejtoria arsimit më pas promovimi i shërbimeve të qps dhe gjithqka tjetër dhe ska mundesi mos me kanë në harmonizim, pasi ata i kanë parapa në nivel nacional dhe do të harmonizohen me nivelin lokal.

Elbasan Osmani pasi përshëndeti të gjithë theksoi se kjo strategji është e mirëseardhur, duhet të theksohet se mrena kësaj strategjie është bërë diçka edhe për bizneset start up dhe për shkollën “Shaban Hashani” janë aty do miç që po i pengojnë këto procese, sa i përket moshës mund të kemi edhe më pak, mirëpo duke i pa këto fjalime distrikteve po më doket vetja që i kam 300 vjet dhe jo 60.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë dhe kaloi me 24 vota për, dhe 4 kundër.

Kryesuesi e lexoi pikën e 8 dhe ia kaloi fjalën Sabri Murselit i cili theksoi se ky propozim ka të bëjë me publikimin e listës se pronave, këtë vit e kemi pru më heret për shkak të mundësive dhe te pika 11 deri 15 ipen vetëm objektet dhe jo pronat.

Besim Haziri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se ky propozim listat mungojnë pa material kjo pikë ska kuptim, unë se kuptojë komunën, pse po i lejon këto parregullsi pasi sipas auditorit konkluzioni i tij është se komuna ska arrit që ta rris çmimin e dhënies së pronës në shfrytëzim dhe 3 raste janë evidentu që qiramarrsit e kanë bartë tek palët e treta edhe pse e kanë pasur të ndaluar, mos me kanë dosta shok me siguri si kish leju, ka rast ku mbi 50 mi euro borgje dhe ska arrit me i inkasu ato mjete, duke patur biznese që kanë interes me i marr e me i mbajt qysh duhet. Dhe kam një pyetje?, a e ke pru edhe këtë në listë.

Arian Imeri se kuptova kolegun, a është për aprovim apo për kundërshtim të kësaj pike pasi s’besojë që duhet në këtë formë të pengohet, unë mendoj që duhet të aprovohet lista në parim, ndërsa për rastet që kanë probleme të adresohen në kuvend dhe të shikohet mundësia, ju faleminderit.

Flamur Istrefi, ne jemi kundër për shkak të formës që ka ardhë, është drejtori sponsorisus i kësaj liste dhe smundesh me pas krejt muajin në dispozicion dhe me naj pru këtë pikë kështu, unë s’kam list, unë se di çka ke fut aty, raporti ka kallzu që si ke pas listat e pronave që i ke dhanë në shfrytëzim.

Kryesuesi e hodhi në votim dhe kaloi me 21 vota për, 10 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 9 dhe ia kaloi Sabri Murselit i cili tregojë elebaroi si në propozim, besoj që është mjaft i detajuar kjo, është shpall interes i përgjithshëm më heret pra ka të bëjë me zhvendosje të rrugës, dhe u hodh në votim dhe kaloi me 33 vota për, 2 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi piken e 10 dhe ia kaloi fjalën drejtorit Sabri Murseli i cili theksoi se ky propozim ka të bëjë me këmbim në Talinovc me sipërfaqe prej 32 ari, arsyeja është pasi është nisur të ndërtohet çerdhe dhe pasi është bërë vlersimi propozoj të kaloj.

Arbnora Salihu unë e kam një pyetje?, prona në të cilën po ndërtohet prona kultura është varreza dhe aty është edhe strërgjyshi im dhe po du me ditë a kanë mu zhvarros dhe drejtori theksoi që pas formimit të komisionit do të barten.

Brahim Osmani pyetjen po ja bëjë drejtorit?, pjesën ku është bashkëfinancim a keni me ja dhënë në(nuk ndëgjiohet)


Dhe kjo pikë kaloi me të gjitha votat për, asnjë kundër asnjë abstenim.

Kryesuesi në pikën e 11 ia kaloi fjalën Brahim Osmanit i cili theksoi se po e parashtron këtë pyetje për Drejtorin e bujqësisë, theksoi se në mandatin e parë ai ka premtu dhe kryetari i komunës me mëngjes në Fshatin Rahovic vike dhe qojke foto, thojke parku i pishave dhe aty ska asnjë punë më.

Në të ndryshme Adnan Selmani pasi përshëndeti të gjithë theksoi; pas shumë të interesuar për strategjinë e rinisë dhe nëse bash ashtu e keni hallin hajde bashkë e bëjmë një strategji, ju faleminderit.

Kryesuesi theksoi se pasi ska tjerë të interesuar e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi